

Armend MEHMETI

KRIMET E FORCAVE SERBE NË KOSOVË NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE (1918-1941)

Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, në Kosovë u rivendosën forcat ushtarake serbe dhe rrjedhimisht Kosova dhe viset tjera veriore shqiptare, të ndara nga trugu amë më 1913, mbetën sërish nën sundimin sllav - Mbretërinë Serbe-Kroate-Slllovene (më vonë Jugosllavia). Politika që ky shtet ndoqi ndaj shqiptarëve ishte vazhdimësi e asaj e viteve 1912-1915. Thelbi qëndronte në ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës në favor të elementit sllav, prandaj për të arritur një synim të tillë u përdorën programe dhe metoda të ndryshme politike, administrative e ushtarake/policore.

Punimi “Krimet e forcave serbe në Kosovë ndërmjet dy luftërave botërore (1918-1941)”, që realizohet në kuadër të projektit “*Gjenocid serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX*”, të Institutit të Historisë “Ali Hadri” në Prishtinë, trajton krimet që forcat ushtarake e të xhandarmërisë serbe kryen kundër shqiptarëve gjatë periudhës në fjalë sikurse vrasjet, eliminimet fizike, plaçkitjet, djegiet e vendbanimeve, internimet etj. Nga analizimi dhe krahasimi i fakteve del se pushteti serb me pretekstin e çarmatimit e më pas edhe të ruajtjes së stabilitetit shtetëror kreu vrasje në masë (mbi 12 000 vetëm deri më 1921), shkatërrime të vendbanimeve, ndërmori masa të ndryshme administrative nën presionin policor për të privuar shqiptarët nga prona e për të nxitur shpërnguljen, mohoi të drejtat elementare njerëzore dhe etnike dhe një varg masash tjera të cilat kishin për qëllim të realizonin ndryshimin e strukturës etnike në Kosovë apo për shkombëtarizimin e saj nga shqiptarët. Ofensiva e trupave Aleate që kishte filluar kah mesi i shtatorit të vitit 1918 kundër trupave të Boshtit në pjesën jugore të Ballkanit e kishte detyruar Bullgarinë që të nënshkruante kapitullimin më 29 shtator 1918.¹ Në prag të fitores së Aleatëve shqiptarët që jetonin në Kosovë e trevat tjera shqiptare të shkëputura nga trugu amë më 1913, u përballën me kërcënimin e parë të drejtpërdrejtë nga ushtria serbe. Aviacioni ushtarak serb shpërndau përmes avionit rreth 5 000 kopje

¹ L. S. Stavrianos, *The Balkans since 1945 (with a new Introduction by Traian Stoyanovich)*, London: Husrst & Company, 2000, f. 569.

të një proklamate në gjuhën turke, kryesisht në Prishtinë, Mitrovicë, Kumanovë, Novi Pazar, etj., në të cilën shqiptarët, përveç se njoftoheshin për rrugët nga do të kalonte ushtria serbe, atyre u përkujtoheshin “veprimet” e tyre të vjeshtës së vitit 1915, dhe “për të mbetur miq përsëri”, shqiptarët jo vetëm se nuk duhej ta pengonin depërtimin e ushtrisë serbe në Kosovë, por edhe të ngriheshin kundër austro-hungarezëve dhe gjermanëve dhe t’i mbronin serbët në Kosovë.²

Proklamata në fjalë paraqiste sinjal të qartë për qëndrimin që do ta mbanin trupat ushtarake serbe ndaj popullatës shqiptare në Kosovë. Pas shpërthimit të Frontit të Selanikut, nga drejtimi i jugut së pari depërtuan në Kosovë forcat franceze, të cilat në periudhën 5-12 tetor 1918 vendosën kontrollin e tyre në pjesën më të madhe të Kosovës, për të siguruar hapësirën Prizren-Prishtinë-Mitrovicë-Prepolc, në pritje për t’u zëvendësuar nga forcat e Armatës II serbe.³ Ky akt dëshmon se fuqitë aleate njihnin kufijtë e Serbisë së periudhës para Luftës së Parë Botërore. Marshimi i ushtrive serbe në drejtim të Kosovës filloi më 15 dhe 16 tetor 1918. Regjimenti II i Divizionit jugosllav kishte për detyrë të marshonte në linjën Prishtinë-Mitrovicë-Runik-Pejë, në kohën kur Divizioni i Timokut dhe i ai i Shumadisë tanimë kishin arritur në Kaçanik.⁴ Këto njësite depërtuan edhe në rajonet në brendi të Kosovës, kurse më 23 tetor 1918 Komanda e Armatës II Serbe e urdhëroi Divizionin jugosllav që të qëndronte në Kosovë me njësi të dislokuara në Ferizaj, Prizren, Gjakovë, Pejë, Prishtinë dhe Mitrovicë.⁵

Rivendosja e forcave ushtarake serbe, tani nën maskën e një shteti të ri - Mbretërisë Serbo-Kroate-Slllovene, më vonë si Mbretëria e Jugosllavisë, nënkuptonte edhe rifillimin e dhunës dhe të politikës antishqiptare që ishte ndërprerë me rastin e largimit të tyre nga Kosova gjatë Luftës së Parë Botërore. Qëllimi i kësaj politike konsistonte në integrimin e plotë të trevave shqiptare në shtetin serb-kroat-sllloven dhe në parandalimin e shkëputjes së tyre, një qëllim që mund të arrihej vetëm me ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës, respektivisht uljen e numrit të shqiptarëve dhe

² Bogumil Hrabak, “Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanaškom većinom stanovništva u jesen 1918. godine i držanje arbanasa prema uspostavljenjnoj vlasti”, Gjurmime Albanologjike, Seria e Shkencave Historike, Nr. 1-1969, Prishtinë, 1969, f. 255.

³ B. Hrabak, “Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države...”, f. 256-257.

⁴ Велики рат Србије за ослобођење и уједињење срба, хрвата и словенаца 1918-1919, књига тридесета, Београд, 1937, f. 36, 83.

⁵ Liman Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë (1919-1928)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2016, f. 32.

shtimit të elementit sllav.⁶

Në arritjen e qëllimit të mësipërm, në periudhën e menjëhershme pas ripushtimit pushteti serb-kroat-slloven nën pretekstin e çarmatimit të popullsisë shqiptare përdori dhunën sistematike dhe terrorin shtetëror, që manifestohej me vrasje masive dhe djegie e shkatërrime të vendbanimeve, ndërsa me fazat e mëvonshme edhe të mekanizmave e metodave të ndryshme politike, sikurse: shpronësimi përmes reformës agrare, kolonizimi dhe vendosja e elementit sllav në tokat e shpronësuara, mobilizimi dhe rekrutimi i dhunshëm i të rinjve shqiptarë në ushtrinë serbe, internimi i familjeve shqiptare, etj.

Gjitha këto veprime kishin për qëllim spastrimin etnik të Kosovës, në veçanti të trevave kompakte shqiptare. Në këtë mënyrë gjatë viteve 1918-1941 u kryen një varg krimesh kundër popullsisë shqiptare në Kosovë, të planifikuara dhe të zbatuara nga organet shtetërore të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene. Vala e dhunës antishqiptare filloi me ndjekjen që ushtria serbe i bëri asaj bullgare gjatë tremujorit të fundit të vitit 1918. Në këtë ndjekje, ushtria serbe duke kaluar në fshatrat shqiptare të Karadakut, të Moravës e të Gollapit kishte kryer mobilizimin e dhunshëm të një numri të rinjsh shqiptarë, të cilët i kishte dërguar në drejtim të Aleksincit, të cilët më pas edhe i kishte ekzekutuar.⁷ Në fund të shtatorit të vitit 1918, para se formacionet ushtarake serbe të marshonin drejt Kosovës, qeveria serbe me seli në Selanik jo vetëm se kishte caktuar drejtuesit e pushtetit lokal në Kosovë, por kishte formuar edhe gjykata me gjykatës serbë të cilët kishin autorizime të pakufishme, që shkonin edhe në të drejtën e dënimeve me vdekje në mungesë të burgjeve. Kështu, gjatë marshimit ushtarak në afërsi të Mitrovicës ushtarakët serbë pa asnjë lloj gjyqi pushkatuan 36 shqiptarë, kurse rreth 116 të tjerë i internuan në Serbi.⁸

Më pas fushata antishqiptare kishte vazhduar me aksionet për çarmatimin e shqiptarëve, me pretekstin se ata mund t'i kundërviheshin pushtetit. Çarmatimi, sipas burimeve jugosllave filloi qysh në ditët e fundit të tetorit të vitit 1918,⁹ për të rivazhduar ditët e para të nëntorit të vitit 1918. Më 7 nëntor 1918 Komanda Supreme Serbe e urdhëroi Divizionin jugosllav që *“krahas regjimentit të këmbësisë të përdorej edhe artileria në*

⁶ Sabri Rexha, *Raportet shqiptaro-serbe në Kosovë*, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2011, f. 160.

⁷ Dan Ibrahim, *Gjenocidi serb në Malësinë e Galabit (Gollakut) të Prishtinës (1912-1999)*, Prishtinë: Shtëpia Botuese ProkultPress, 2015, f. 21.

⁸ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëllimi III, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 444.

⁹ *Arkivi i Kosovës* (më tej: AK), Fondi: Arkivi i ish ushtrisë jugosllave, Dosja: Popisnik 4/2, 1914-1920.

çarmatosjen e shqiptarëve në anën e majtë të lumit Sitnica, të cilët ishin çuar në kryengritje".¹⁰ Aksioni në fjalë kishte të bënte me shtypjen e rezistencës shqiptare, e cila kundërshtonte vendosjen e ripushtimit serb dhe që në këtë periudhë kishte kryesisht karakter lokal.¹¹ Sipas burimeve jugosllave një rezistencë kundër pushtetit krahas Vushtrrisë ishte shfaqur edhe në rajonin e Llapit.¹²

Operacioni në fjalë përfshinte një hapësirë të madhe territoriale duke u zgjeruar edhe në rrethinën e Lipjanit dhe një pjesë të Drenicës. Më 10 nëntor Komanda e Divizionit jugosllav njoftonte se çarmatosja e popullsisë shqiptare në Drenicë, Runik dhe Deviç po kryhej në "mënyrë energjike", se artileria ishte në dispozicion dhe se operacioni do të shtrihej edhe në rrethinën e Istogut.¹³ Se operacioni kishte shtrirje të gjerë, dëshmonte edhe një raport tjetër i po kësaj komande, i cili njoftonte më 12 nëntor për disa shtëpi të djegur që ishin rezultat i rezistencës shqiptare.¹⁴ Në analizën që Komanda e Divizionit jugosllav i bëri aksionit për çarmatimin e popullsisë shqiptare, që kishte zgjatur nga data 9 deri më 13 nëntor 1918, vihej në pah koha e shkurtër për një aksion që përfshinte një territor shumë të gjerë, dhe se nuk ishin gjetur armë te shqiptarët, të cilët shpesh edhe largoheshin nga shtëpitë para se të arrinte ushtria në fshat, prandaj edhe i kishin fshehur ato. Por, në raport theksohet se "... aksioni kishte ngritur reputacionin e shtetit, ngase përdorimi i dhunës ishte i domosdoshëm".¹⁵

Raporti jep indikacione të qarta për dhunën e paramenduar, të planifikuar e të përdorur nga ushtria serbe. Në qetësimin e rajoneve të Drenicës dhe të Vushtrrisë ishte përdorur edhe metoda e marrjes së pengjeve. Rreth 10 persona me ndikim u arrestuan nga togjet e Regjimentit 21 të ushtrisë jugosllave, që po operonin në linjën Deviç-Runik-Istog. Të njëjtit më 19 nëntor 1918 u dërguan në drejtim të Çaçakut.¹⁶ Dhuna ushtarake serbe rifilloi në muajt e parë të vitit 1919. Në dimrin e ashpër të shkurtit të vitit 1919 forcat serbo-malazeze sulmuan krahinat e Plavës e të Gucisë. Pas thyerjes së forcave shqiptare dhe tërheqjes së tyre në male,

¹⁰ *Po aty*, Dosja: Popisnik 3, 1914-1920; B. Hrabak, "Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države...", f. 273.

¹¹ L. Rushiti, *Lëvizja kaçake në Kosovë...*, f. 81; Mikel Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999)*, Prishtinë, 2001, f. 42.

¹² AK, Fondi: Arkivi i ish ushtrisë jugosllave, Dosja: Popisnik 3, 1914-1920.

¹³ Велики рат Србије за ослобођење и уједињење срба, хрвата и словенаца 1918-1919, књига тридет и прва, Београд, 1939, f. 131.

¹⁴ *Po aty*, f. 159.

¹⁵ B. Hrabak, "Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države...", f. 276-277.

¹⁶ Б. Храбак, "Стање на Косову, у Метохији и западној Македонији (од октобра 1918. до марта 1919. Године)", *Лесковачки Зборник*, Бр. ХЛ-2000, Лесковац: Народни Музеј у Лесковцу, 2000, f. 54.

banorët që u zunë nga forcat serbo-malazeze përjetuan masakrat më mizore. U ekzekutuan mbi 1 000 vetë, mbi 1 000 shtëpi u dogjën, kurse rreth 5 000 banorë tjerë u detyruan t'i braktisnin shtëpitë e tyre.¹⁷

Dhuna e pushtetit serb nuk kurseu as qytetet. Krahas arrestimeve të parisë së Prishtinës, u plaçkit tregu i Pejës, kurse në rajonin e po të njëjtit qytet forcat serbe bombarduan dhe rrafshuan me tokë shumë fshatra të Podgurit.¹⁸ Dhuna u shtri edhe në krahinën e Rugovës, ku gjatë shkurtit të vitit 1919 forcat serbe sulmuan vendbanimet dhe ekzekutuan gjithë ata që i gjetën nëpër shtëpi të tyre, duke mos i kursyer as fëmijët, gratë e pleqtë:

- Stupec i Madh: 83 të vrarë, 52 shtëpi të djegura;
- Stupec i Vogël: 94 të vrarë, 60 shtëpi të djegura;
- Drelaj: 24 banorë të vrarë, 41 shtëpi të djegura;
- Kaçishtë: 57 të vrarë, 60 shtëpi të djegura;
- Rekë: 16 të vrarë, 6 shtëpi të djegura;
- Malaj: 17 të vrarë, 35 shtëpi të djegura;
- Koshutan: 31 të vrarë, 42 shtëpi të djegura;
- Shkrel: 18 të vrarë, 58 shtëpi të djegura;
- Bogë: 15 të vrarë, 23 shtëpi të djegura;
- Dukajevë: 17 të vrarë, 34 shtëpi të djegura;
- Stankaj: 11 të vrarë, 25 shtëpi të djegura;
- Haxhaj: 7 të vrarë, 28 shtëpi të djegura;¹⁹

Krahas vrasjeve, shkatërrimeve dhe djegies së shtëpive, forcat serbe plaçkitën banorët dhe gjithë pasurinë e luajtshme, kurse grabitën edhe bagëtinë dhe produktet ushqimore. Plaçkitjet kryheshin edhe nga popullata civile serbe e malazeze. Sipas të dhënave të qarqeve ushtarake serbe, të datës 24 mars 1919, kolonët malazezë që ishin vendosur në rrethinën e Pejës po kryenin krime të ndryshme ndaj popullsisë shqiptare në qytetin e Pejës, kurse në rrethinën e Istogut dhe të Klinës kishin kryer plaçkitje dhe djegie të vendbanimeve. Nga 20 shkurti deri më 22 mars 1919 në Kerninë të Istogut u ekzekutua një familje prej 16 anëtarësh, një tjetër prej pesëmbëdhjetë anëtarësh, dhe në Baran të Pejës një familje prej 11 anëtarësh - burra, gra, fëmijë e pleq.²⁰ Në operacionet kundër popullsisë shqiptare pushteti serb-kroat-sllloven kishte angazhuar edhe formacione të pavarura çetnike, sikurse ajo e çetnikut të famshëm Kosta Peçanac. Kah pjesa e fundit e prillit të vitit

¹⁷ Elmas Plava, *Plava e Gucia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, Tiranë, 1995, f. 139-146.

¹⁸ *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar, 1918-1920*, Përmbledhje dokumentesh, Vëllimi I, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSH të Shqipërisë, 1975, dok. 28, f. 62.

¹⁹ Hakif Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*,

Prishtinë: QIK, 1995, f. 78-80.

²⁰ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 49-50.

1919 Komanda e Brigadës I jugosllave i vuri atij në dispozicion rreth 105 ushtarë nga ushtria e rregullt që gjendej në Rudnik me qëllimin e shuarjes së kryengritjes, luftimit të kaçakëve dhe të sigurimit të rrugëve.²¹ Këto forca u drejtuan edhe kundër popullsisë civile, jo vetëm kundër kaçakëve. Terrori dhe vrasjet që formacionet çetnike të drejtuara nga Kosta Peçanci dhe Miliq Krsta kryen kundër shqiptarëve në pjesë të ndryshme të Kosovës, zgjatën me vite. Sipas disa të dhënave, në vitin 1920 Kosta Peqanac dhe Miliq Krstiq kishin djegur 80 fshatarë dhe plaçkitur 60 000 dhen. Miliq Krstiqi vetë i kishte pushkatuar 36 shqiptarë, prej të cilëve dy pleq, njëri 80 kurse tjetri 115 vjeç.²²

Gjendja e tendosur në Kosovë dhe dhuna sistematike serbe mori një dimension tjetër gjatë dhe pas operacioneve për shuarjen e Kryengritjes shqiptare që kishte filluar në pranverë të vitit 1919, e cila kishte filluar në Plavë dhe ishte përhapur më pas në rrethinën e Vushtrrisë, të Drenicës, të Podrimës, të Rugovës, të Llapit, në Luginën e Moravës e deri në Shkup, Kumanovë e Gostivar.²³

Operacionet për shuarjen e kryengritjes ishin manifestuar me një terror masiv. Sipas një raporti të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” gjatë muajit maj të vitit 1919 terrori serb në rajonin e Pejës dhe të Drenicës kishte marr këto përmasa:

Rajoni i Pejës:

- Zallç - 13 të vrarë, 43 shtëpi të djegura. U grabit edhe bagëtia;
- Zllakuqan - 7 të vrarë, 30 shtëpi të djegura;
- Siçevë - 5 të vrarë, 18 shtëpi të djegura;
- Gjurgjevik i Madh - 7 të vrarë, 43 shtëpi të djegura;
- Jashanicë e Sipërme - 3 të vrarë, 25 shtëpi të djegura;
- Gllarevë - 35 shtëpi të plaçkitura e të djegura;
- Çupevë - 10 shtëpi të djegura;
- Kramovik - 13 të vrarë;
- Pastasellë - 93 të vrarë;
- Jabllanicë - 28 të vrarë, 20 shtëpi të plaçkitura e të djegura;
- Jabllanicë e Vogël - 26 të vrarë;
- Vrellë - 7 të vrarë;
- Radac - 28 të vrarë, 20 shtëpi të djegura;
- Novosella - 25 të vrarë, 13 shtëpi të djegura;

²¹ Dmtar Tasić, “Između slave i optužbe-Kosta Milovanović Pećanac”, *Istorija 20. Veka*, Br. 2/2007, Beograd: Časopis Instituta za Savremenu Istoriju, 2007, f. 121.

²² Hajredin Hoxha, “Politika e terrorit dhe gjenocidit ndaj shqiptarëve”, Prishtinë: *Përparimi*, nr. 5-1971, 1971, f. 351-354.

²³ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, 463.

- Kaliçani - 31 të vrarë.²⁴

Vrasjet dhe shkatërrimi i vendbanimeve ishte shoqëruar edhe me plaçkitjen e të mirave materiale dhe të ushqimeve. Sipas gazetës “Kosova”, që botohej në Konstancë të Rumanisë, në një artikull të hartuar nga një emigrant kosovar, gjatë majit të vitit 1919 në krahinën e Rahovecit, që përfshinte zonat e Prekorupës, të Podrimës dhe të Bajrakut të Ostrozubit, ushtritë serbe kishin plaçkitur: në Gjurgjevik të Madh - 45 000 kuintalë drithë e 6 500 krerë bagëti; në Jashanicë 4 600 kuintalë drithë e 4 300 krerë bagëti; në Gllarevë 6 000 napolona ari, drithëra e bagëti; vrasje, djegie të vendbanimeve dhe plaçkitje të parave, drithërave dhe bagëtime u kryen edhe në Perçvë, Volljak, Qypevë, Domanek. Zatriq, Drenoc, Postasel, etj.²⁵

Në rajonin e Drenicë krimet serbe kishin këto përmasa:

- Rezallë - 29 të vrarë, 3 shtëpi të djegura, 70 shtëpi të plaçkitura;
- Plluzhinë - 30 shtëpi të plaçkitura;
- Likovc - 6 të vrarë, 4 shtëpi të djegura;
- Llaushë - 4 të vrarë, 3 shtëpi të djegura;
- Çubrel - 5 shtëpi të djegura, 50 të plaçkitura;
- Turiçec - 9 të vrarë, 5 shtëpi të djegura, 20 të plaçkitura;
- Kopiliq - 7 të vrarë, 20 shtëpi të plaçkitura;
- Krajkovë - 4 të vrarë, 30 shtëpi të djegura;
- Obri - 4 të vrarë, 10 shtëpi të djegura, 50 shtëpi të plaçkitura; - Galicë - 7 të vrarë, 5 shtëpi të djegura.²⁶

Fushata e persekutimeve fizike antishqiptare përfshiu edhe rajonin e Vushtrrisë. Në fshatin Popovë forcat ushtarake dhe ato të xhandarmërisë serbe vranë mbi 30 persona të moshave dhe gjinive të ndryshme gjatë muajit maj të vitit 1919. Pas këtij terrori ushtarët dhe xhandarët serbë vazhduan me mizoritë e tyre në rrethinën e Llapit, si në Lupç, Bellopojë, Sharban, Koliq, Keqekollë e Prapashticë.²⁷

Pas shuarjes së Kryengritjes së vitit 1919 një masë tjetër represive e zbatuar nga pushteti ushtarak serb ishte mobilizimi i dhunshëm i rekrutëve shqiptarë. Qëllimi konsistonte në neutralizimin e masave shqiptare të afta për luftë dhe vënien e tyre në shërbim të projekteve të pushtetit serb. Në vazhden e këtij qëllimi qysh në korrik të vitit 1919 u tentua rekrutimi i 3 254 rekrutëve shqiptarë në Divizionin e “Kosovës dhe të Metohisë”, por

²⁴ Arkivi Qendror i Shtetit (më tej: AQSh), Fondi: F. 446 Komiteti i Kosovës, D. 1-29, f. 6-12.

²⁵ Gazeta Kosova, Konstancë, 25 maj 1933.

²⁶ AQSh, Fondi: F. 446 Komiteti i Kosovës, D. 1-29, f. 6-12.

²⁷ Fahri S. Buçinca, Ferid B. Dibrani, *Mizoritë serbe në Vushtrri dhe rrethinë, 1918-1956*, Prishtinë, 2009, f. 35.

përpjekja dështoi për shkak të përgjigjes jashtëzakonisht të dobët. Si shkas u formuan njësi speciale për ndjekjen e rekrutëve të arratisur.²⁸

Duke filluar nga viti 1920 përpjekjet për persekutimin e shqiptarëve po merrnin një formë zyrtare dhe të programuar përmes planifikimit të një operacioni të përgjithshëm në tërë Kosovën, ngaqë ato të vitit 1919 kishin qenë të pjesshme. Gjatë bisedimeve për planifikimin e një operacioni të tillë te qarqet ushtarake serbe në një mbledhje të mbajtur në Shtabin e Armatës III në Shkup, më 31 dhjetor të vitit 1919, ishte konstatuar se çarmatimi i popullsisë duhej kryhej doemos para stinës së pranverës dhe atë fillimisht në rajonet: Drenicë, Podgor i Pejës, Topolan, Shishtëvac, Kabash, Llap, Shalë, Podgor i Prizrenit, Shtavicë dhe Peshter. Në plan qëndronte edhe aksioni për kapjen edhe likuidimin e kaçakëve: Azem Bejta, Sadik Rama, Ramadan Shabani, Mehmet Konjuhi, Abib Lupçi, kurse gjatë aksioneve duhej të kishte kujdes për “sa më pak djegie dhe plaçkitje të shtëpive”.²⁹ Duhet theksuar edhe faktin se në mbledhjen e cekur, ishte kërkuar nga Ministria e Ushtrisë në Beograd rikthimi në fuqi i Ligjit të vitit 1905 për hajdutët,³⁰ në mënyrë që shqiptarët të konsideroheshin të jashtëligjshëm e të vriteshin pa kurrfarë përgjegjësie gjithë ata që nuk i nënshtroheshin pushtetit serb. Ndonëse një kërkesë e tillë nuk ishte miratuar për shkak të rrethanave politike, megjithatë ajo tregon shkallën e urrejtjes dhe shovinizmin e pakufishëm të pushtetit serb kundrejt shqiptarëve.

Si rezultat i këtyre planifikimeve më 17 shkurt 1920 përmes një komunikimi ndërqeveritar, Ministria e Punëve të Brendshme kërkoi nga Ministria e Ushtrisë së Mbretërisë SKS që të kryhej çarmatimi i popullsisë në Kosovë, Sanxhak dhe në Maqedoni.³¹ Forcat ushtarake ishin të detyruara të bashkëpunonin me kryeshefat e qarqeve,³² që i jepte aksionit edhe karakterin politik. Operacioni për çarmatosjen e popullsisë filloi më 11 mars 1920, së pari në Qarkun e Zveçanit dhe të Kosovës, në anën e majtë të lumit Sitnicë dhe anën e djathtë të lumit Lepenc, kurse më pas do të vazhdonte edhe në qarqet tjera. Çarmatimi duhej të kryhej brenda 10 ditësh, kurse Komanda e Armatës III inkurajonte njësitë vartëse që operacioni të kryhej “... në mënyrë të rrufeshme, sepse elementi kryengritës shqiptar duhet befasuar me sulm të përqendruar, përndryshe populli që ka mbetur në

²⁸ Владан Јовановић, “Сузбијање качака на Косово и Метохију 1912-1929”, Београд: Војноисторијски гласник, бр. 1-2009, Институт за стратегијска истраживање, 2009, ф. 43.

²⁹ *Po aty*, f. 46.

³⁰ АК, Fondi: Аркиви i ish-Ushtrisë Jugosllave, Dosja: Popisnik 2, Sveska 3, 1912-1920.

³¹ *Po aty*, Dosja: Popisnik 3, 1914-1920.

³² *Po aty*, Dosja: Popisnik 2, 1912-1920.

shtëpi nuk do t'i dorëzojë armët".³³ Aksioni i çarmatimit ishte shoqëruar me dhunë, vrasje, djegie shtëpish, etj. Shkatërrimet e vendbanimeve dhe djegiet e shtëpive ishin të evidentuara në një raport hetues ushtarak të Komandës së Armatës III.³⁴ Në vazhden e kësaj fushate u dogj fshati Çikatovë në rrethin e Drenicës. Ekzekutuesit arsyetoheshin se "*kemi qenë të detyruar të përdorim artilerinë kudo që nuk janë dorëzuar shqiptarët me dëshirë*".³⁵

Më 25 mars 1920 Komanda e Divizionit të qarkut të Kosovës e njoftonte Komandën e Armatës III se kishte përfunduar aksioni për çarmatosjen e popullatës në linjën Lepenc-Sitnicë-Ibër, ndërsa janë marr masa për çarmatosjen edhe të territoreve tjera, kurse linja Lipjan-Mitrovicë dhe ajo Lipjan-Kaçanik mbetej e bllokuar.³⁶ Në fund të marsit operacioni i çarmatosjes u shtri edhe në rrethin e Pejës, kurse si arsyetim i rezistencës së shqiptarëve komanda lokale në Pejë kishte kërkuar nga komanda e Zetës mbështetje me 1 000-1 500 ushtarë për të shuar kryengritjen shqiptare.³⁷

Fushata e çarmatimit zgjati deri në qershor të vitit 1920. Po këtë muaj, qarqe të caktuara politike të Mbretërisë SKS i dërguan Komandës së Armatës III në Shkup programin për pengimin e realizimit të ideve kombëtare shqiptare në Kosovë, respektivisht pengimit të krijimit të një Shqipërie etnike, dhe të nënshtrimit të plotë të shqiptarëve. Ndër masat e propozuara ishin: hapja e një zyrës në Shkup që do ta koordinonte politikën ndaj shqiptarëve, përvetësimi i parisë shqiptare, internimi, kolonizimi, si dhe organizimi i administratës serbe në funksion të nënshtrimit të shqiptarëve.³⁸

Në bazë të këtij programi organet ushtarake të Mbretërisë SKS hartuan në vjeshtë një plan të ri për çarmatosjen e popullsisë shqiptare në Kosovë për të penguar, sikurse arsyetohej, një kryengritje të re shqiptare në pranverë. Sipas këtij plani, operacioni për çarmatosje duhej të fillonte në dimër në rajonin e Llapit, e për të vazhduar më pas edhe në rajonet tjera. Zgjedhja e dimrit 1920-1921 nuk ishte e rastësishme, sepse në këtë periudhë, kur koha ishte e ftohtë dhe me borë, shqiptarët nuk do të mund të largoheshin maleve, kurse popullata do të pësonte edhe nga të ftohtët dhe acari dimëror. Kështu, në fund të dhjetorit të vitit 1920 dhe në fillim të janarit të vitit 1921 filluan operacionet e njëjive ndëshkuese të xhandarmërisë në fshatrat e Llapit e të Gollapit, respektivisht në Sharban,

³³ H. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941*, Prishtinë, 1981, f. 99-101.

³⁴ AK, Fondi: Arkivi i ish-Ushtrisë Jugosllave, Dosja: Popisnik 2, 1912-1920.

³⁵ H. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike...*, f. 99-103.

³⁶ AK, Fondi: Arkivi i ish-Ushtrisë Jugosllave, Dosja: Popisnik 1915-1920, Kutia 9.

³⁷ *Po aty*, Dosja: Popisnik 3, 1914-1920.

³⁸ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 78; H. Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb...*, f. 68-73.

Bellopojë, Keçekollë, Prapashticë, Nishevc, Kushevicë, Repë, Popovë, Velika Rekë, Gerdovc dhe Vranovc.³⁹

Në Keçekollë, sipas të dhënave të kohës ushtria dhe xhandarmëria serbe në ditët e para të janarit 1921 ekzekutoi 490 njerëz të të gjitha moshave e gjinive. Në mesin e të vrarëve ishte edhe imami i fshatit me familjen e tij dhjetë anëtarësh.⁴⁰ Nga 12 familje sa jetonin në lagjen Qorraj të Keçekollës 11 pothuaj u shuan plotësisht. Vetëm në këtë lagje ishin ekzekutuar 63 njerëz të të gjitha moshave, kurse 35 tjerë u ekzekutuan në lagjen Sinanaj. Po ashtu u ekzekutuan: 6 persona nga familja Limanaj, 23 vetë nga familja Kurtaj, 11 nga familja Spahiaj, etj.⁴¹

Krimi më i rëndë u krye në fshatin Prapashticë më 11 janar 1921. Një ditë më parë, pikërisht më 10 janar në këtë fshat arriti ekspedita ndëshkuese nën komandën e majorit Radovan Radojeviq. U thirrën gjithë meshkujt e moshës 17-70 vjeç dhe pas një bisede u liruan në shkonin, por me kushtin të paraqiteshin të nesërmen. Serbët që jetonin në këtë fshat e informuan majorin Radojeviq lidhur me vrasjen e rreth 20 serbëve më 1912 në rrethinat e Prapashticës. Radojeviq kthehet më 11 janar në Prapashticë dhe i tubon banorët e gjithë fshatit, të cilët i pushkaton. Në këtë mënyrë u pushkatuan rreth 1 020 burra, gra e fëmijë. Nga kjo ngjarje kishte shpëtuar rastësisht Liman Jetullahu, i cili edhe e kishte rrëfyer këtë ngjarje të tmerrshme.⁴² Përveç vrasjes së 1 020 civilëve shqiptarë, në Prapashticë ishin plaçkitur e djegur 80 shtëpi.⁴³

Ekspeditat ndëshkuese të pushtetit serb u shtrinë edhe në fshatrat tjera. Në Bellopojë të Podujevës u ekzekutuan 30 persona dhe ishin djegur 32 shtëpi. Në Nishec ishin ekzekutuar 14 persona. Në Gerdovc të Podujevës u shfarosën dy familje me gjithsej 25 anëtarë. Në Orllan u vranë 9 anëtarë të një familjeje, si dhe një grua me tetë fëmijë. Fati i njëjtë e kishte përcjellë edhe një familje në Kushevicë të Podujevës.⁴⁴ Në Sharban u ekzekutuan 34 persona të moshës 1-64 vjeç, një pjesë e madhe e të cilëve ishin gra e fëmijë.⁴⁵ Deputetët shqiptarë (Xhemijeti) në parlamentin e Mbretërisë SKS protestuan më 2 janar 1921 ndaj krimeve kundër shqiptarëve. Në reagimin e iniciuar nga deputeti Nazim Gafurri u cekën krimet, përmes shembujve

³⁹ H. Bajrami, *Dëbimi i shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës*, Prishtinë, 1995, f. 207.

⁴⁰ Ramadan N. Ibrahim, *Masakra në Prapashticë dhe Keçekollë- janar 1921*, Prishtinë, 2011, f. 32.

⁴¹ D. Ibrahim, *Gjenocidi serb në Malësinë e Galabit (Gollakut)...*, f. 69-73.

⁴² M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 53.

⁴³ R. N. Ibrahim, *Masakra në Prapashticë dhe Keçekollë...*, f. 32.

⁴⁴ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 53.

⁴⁵ D. Ibrahim, *Gjenocidi serb në Malësinë e Galabit (Gollakut)...*, f. 101-102; F. S. Buçinca, F. B. Dibrani, *Mizoritë serbe në Vushtrri dhe rrethinë, 1918-1956*, f. 39.

konkretë përfshirë edhe identitetin e viktimave dhe vendet e krimit, të ushtrisë dhe të xhandarmërisë së Mbretërisë SKS kundrejt popullatës civile të rajonit të Llapit e më gjerë.⁴⁶ Pavarësisht protestës në instancën më të lartë legjislative të shtetit serb-kroat-sllloven, fushata kundër shqiptarëve vazhdoi sikurse mos të kishte ndodhur asgjë. Më 13 janar 1921 ushtria e xhandarmëria serbe në Ballaban ekzekutoi mbi 20 banorë shqiptarë.⁴⁷

Përveç rajoneve të cekura më lart organet e pushtetit kryen krime edhe në viset tjera të Kosovës. Në fshatin Banjë të Suharekës u vranë 15 persona, në Carallukë të Malishevës 5, kurse në Balincë të Vushtrrisë 10 persona.⁴⁸ Në Rugovë të Pejës iu vu zjarri 13 fshatrave me 410 shtëpi, ku u vranë 846 vetë. Në rrethinën e Pejës u dogjën 420 shtëpi dhe u masakruan 231 vetë, kurse në Istog u dogjën 52 shtëpi e u vranë 187 persona.⁴⁹ Terrori ishte veçanërisht i ashpër në territoret që ishin në kufi me shtetin e pavarur shqiptar, ku repartet ushtarake dhe të xhandarmërisë kryen ekzekutime të shumta, të përcjella me plaçkitje dhe djegie të vendbanimeve.⁵⁰

Gjatë muajve të verës së vitit 1921 vala e terrorit të vazhdueshëm u shtri edhe në pjesët tjera të Kosovës. Më 9 korrik, herët në mëngjes, ekspedita ndëshkuese e ushtrisë e xhandarmërisë serbe e shoqëruar edhe nga bandat çetnike serbo-malazeze të anës së Deçanit, Klinës, Pejës, Gjakovës e Istogut, rrethuan Jabllanicën nga katër anët. Burrat u thirrën në mes të fshatit se aty do të vinte edhe Osman Aga, kryetar i komunës së Cermjanit. U bë bastisja e shtëpive që asnjë mashkull të mos mbetej brenda. Më pas fshatarët u akuzuan si strehues të kaçakëve. Pasi plaçkitja e shtëpive, lidhja e fshatarëve me shoka e rripa. Krimet nisën me vrasjen e Osman Agës, pas shpine. Gjashtëdhjetë meshkuj të lidhur nga moshja 13 vjeç e sipër, u dëbuan jashtë fshatit në Kodrën e madhe dhe u pushkatuan të gjithë. Shpëtuan vetëm dy vetë të mbetur nën të vrrarët. Kufomat e viktimave u varrosën pas pesë-gjashtë ditësh nga fshatarët e fshatrave përreth.⁵¹ Për ekzekutimet në Jabllanicë kishte folur edhe Hasan Prishtina në Këshillin Kombëtar, duke theksuar se pas Jabllanicës ekzekutime, plaçkitje dhe djegie të shtëpive e fshatrave u kryen edhe në fshatrat tjera të Deçanit, sikurse në Raushiq,

⁴⁶ H. Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb...*, f. 86.

⁴⁷ D. Ibrahim, *Gjenocidi serb në Malësinë e Galabit (Gollakut)...*, f. 89-90.

⁴⁸ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 52-53.

⁴⁹ Zekeria Cana, *Shpalime historike*, Pjesa e dytë, Prishtinë: Libri Shkollor, Prishtinë, 1998, f. 161.

⁵⁰ *Historia e Popullit Shqiptar*, Vëll. III, f. 484.

⁵¹ Z. Cana, *Shpalime historike...*, f. 162.

Strellc, Labushë, Isniq, Beleg, Prelep etj.⁵² Pas Jabllanicës ushtria, xhandarmëria e çetnikët serbë-malazezë ia mësynë Krelanit krejtësisht të braktisur, ku vranë kryeplakun, plaçkitën dhe dogjën fshatin. Ekspeditat vazhduan plogjën deri në fund të vitit 1921.⁵³

Gjatë vitit 1921 forcat e armatosura serbe nuk u mjaftuan me kasaphanën e Llapit e Gollakut, të Jabllanicës së Dushkajës, Novosellës së Drinit, Jabllanicës së Vogël e të fshatrave tjera në mbarë Kosovën, iu vërsulën edhe tëbanave të Alpeve shqiptare. Në Pleqe dhe Mylishec vranë 42 barinj bashkë me gra e fëmijë, dhe grabitën 15 krerë bagëti.⁵⁴ Sipas të dhënave që Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës ia kishte adresuar Lidhjes së Kombeve në Gjenevë, gjatë viteve 1918-1921 në Kosovë ishin kryer këto mizori:⁵⁵

Nr.	Rrethet	Të vranë	Të burgosur	Të rrahur	Shtëpi të djegura	Shtëpi të plaçkitura
1.	Prishtinë	4.600	3.650	350	1340	2.190
2.	Vushtrri	2.179	2.940	215	1.463	2.431
3.	Ferizaj	1.690	3.400	190	720	960
4.	Pejë	1.560	3.800	240	714	1.970
5.	Prizren	836	2.700	120	770	1.562
6.	Gjilan	680	2.400	220	450	630
7.	Kaçanik/ H. Elezit	340	1.300	160	290	350
8.	Preshevë	260	970	85	180	240
9.	Mitrovicë	133	1.700	30	42	104
10.	Gjakovë	68	200	25	56	78
	Gjithsej	12.346	23.060	1.635	6.025	10.515

Këto shifra janë të regjistruar nga aktivistët e Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës”, por ekziston mundësia që shifrat të jenë më të larta për shkak të pamundësisë për t’i regjistruar të gjitha.

⁵² M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 55; *Hasan Prishtina (Përmbledhje dokumentesh 1908-1934)*, përgatitur nga Kujtim Nuro dhe Nezir Bato, Tiranë: 8 Nëntori, 1982, f. 111-112.

⁵³ Z. Cana, *Shpalime historike...*, f. 163.

⁵⁴ *Po aty*, f. 186.

⁵⁵ *AQSh*, Fondi: Komiteti Kosovës, Dosja: D: 31/21, Viti 1922; H. Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb...*, f. 96; Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavija 1918-1927*, Tiranë: Shtypshkronja botuese “Enciklopedike”, 1992, f. 133; M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 56.

Krahas fushatës së çarmatimit, qarqet politike serbe filluan të mendonin edhe për masat shtesë në arritjen e qëllimeve të tyre për dëbimin e popullsisë shqiptare nga Kosova. Në takimet që mbanin drejtuesit e qarqeve lindi ideja për “ndëshkimin e familjeve dhe të fshatrave kaçake” apo thjesht, miratimin e një ligji pak a shumë të ngjashëm me “Ligjin për hajdutërinë” të vitit 1905. U menduan disa masa sikurse “armatosja e elementit besnik”, ashpërsimi i masave gjatë çarmatosjes së shqiptarëve (rrahja, internimi, robërimi, deri tek dënimi me vdekje), punësimi i shqiptarëve në ndërtimin e rrugëve, sepse supozohej se një rrogë do t’i largonte ata nga pushkët, e deri tek zhvendosja e artilerisë nga Nishi në Gjakovë. Në vazhden e planeve të tilla në janar të vitit 1921 ministri i Punëve të Brendshme lëshoi shpalljen për amnistinë e kaçakëve që do të dorëzoheshin, përndryshe ata që nuk dorëzoheshin i priste masa e internimit të familjeve të tyre.⁵⁶

Në këtë shpallje parashihej internimi jo vetëm i familjes së kaçakut, por edhe të tërë fshatit nëse e ruante ose mbante atë. Fshatarët ishin të obliguar t’i furnizonin me ushqime dhe t’i plotësonin gjitha nevojat tjera të ushtrisë e xhandarmërisë serbe nëse ata do të zhvillonin operacione kundër kaçakëve, gjatë gjithë kohës sa do të zgjaste aksioni.⁵⁷ Dy muaj më vonë filloi aksioni për internimin e familjeve kaçake. Familjet kaçake u vendosën në llogore speciale në Nish dhe Gornji Milanovac. Më 23 mars 1921 u internuan në Nish dy familje shqiptare me nga 8 anëtarë. Sipas raportit të Mihailo Ceroviqit, komisar special për Kosovë, të datës 10 prill 1921, nga qarku i Kosovës dhe ai i Dukagjinit ishin internuar 70 familje me gjithsej 259 anëtarë, kurse nga rajonet tjera edhe 35 familje me 166 anëtarë. Kështu pra, me këtë rast u internuan gjithsej 105 familje me 433 anëtarë, të cilat qëndruan në internim dy deri në tre vjet.⁵⁸

Në aspekt të vlerësimit territorial në kampin e Nishit ishin internuar: nga qarku i Metohisë, 21 familje me 74 anëtarë; nga qarku i Zveçanit 22 familje me 60 anëtarë; nga qarku i Kosovës 16 familje me 81 anëtarë; nga qarku i Prizrenit 11 familje me 44 anëtarë etj.⁵⁹ Me rastin e internimeve nuk bëheshin dallime në moshë e gjini. Internoheshin meshkuj, gra, pleq e shtatzëna, fëmijë, etj. Nga familja Loshaj e fshatit Padalishtë, komuna e Istogut, u internuar tri familje. Në to, tri gra shtatzëna lindën tre djem.⁶⁰ Persekutimet ndaj popullsisë shqiptare me pretekstin e ndjekjes së kaçakëve vazhduan edhe gjatë vitit 1922, ndonëse jo me intensitetin e vitit paraprak,

⁵⁶ В. Јовановић, “Сузбијање качака на Косово и Метохију 1912-1929”, f. 47-49.

⁵⁷ L. Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë...*, f. 181.

⁵⁸ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 54.

⁵⁹ Haki Kasumi, “Internimi i familjeve të kaçakëve”, *Azem Bejtë Galica*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2009, f. 97.

⁶⁰ L. Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë...*, f. 184.

që pjesërisht mund t'i atribuohet vendosjes së raporteve diplomatike midis Shqipërisë dhe Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene dhe të formimit nga ana e Konferencës së Ambasadorëve të Zonës neutrale të Junikut,⁶¹ ku gjetën strehë një pjesë e konsiderueshme e kaçakëve. Gjatë vitit në fjalë pushteti serb ushtroi dhunë në të gjithë Kosovën, ndërsa të dhëna më të plota kemi për rrethinën e Pejës dhe Istogut . Në fshatin Shalinovicë gjatë marsit 1922 u vranë 8 shqiptarë, në Zallç 15 shqiptarë dhe 12 shtëpi u dogjën, kurse gjatë prillit edhe 78 persona tjerë: Raushiq - 15, Orroberde - 8, Ruhot - 6, Lutogllavë - 6, Prapaqan - 8, bjeshkë të Isniqit - 8, Buçan - 9, etj. Në fakt, gjatë këtij viti, në këtë rrethinë u vranë gjithsej 103 veta, u dogjën 36 shtëpi dhe u grabitën 39 000 krerë bagëti të imëta e të trasha, dhe 40 000 kuintalë drithë.⁶²

Si rezultat i masave drastike, rrethanave të karakterit social-ekonomik në Kosovë, të likuidimit të Zonës neutrale të Junikut, të forcimit të kontrollit të kufijve, dhe të zhvillimeve politike në Shqipëri, gjatë vitit 1924 erdhi deri te dobësimi i Lëvizjes Kaçake, ndërsa njëkohësisht, në anën tjetër, pushteti serbo-kroat-slloven ishte i vendosur që me çdo kusht ta shuante rezistencën e armatosur shqiptare. Për t'i dhënë goditjen përfundimtare dy krerëve të devotshëm të kësaj lëvizjeje, Azem Bejtës e Mehmet Konjuhiti, pushteti serb organizoi fushata brutale ushtarake, të shoqëruara me vrasje të banorëve shqiptarë. Në acarin e 10 shkurtit të vitit 1924 forcat serbe sulmuan shtëpinë e Mehmet Konjuhiti në Dumnicë. Udhëheqësi i operacionit ushtarak, majori Peroviq, kishte urdhëruar ushtarët e tij: *“Të vriten të gjithë, krejt çka shihni para vetes të digjet”*. Ndonëse Mehmet Konjuhi arriti të çante rrethimin, forcat serbe vranë 25 vetë, prej të cilëve 18 ishin gra e fëmijë.⁶³

Më 12 korrik të vitit 1924 me urdhër të qeverisë serbo-kroate-sllovene Komanda e Armatës III me seli në Shkup urdhëroi nisjen drejt Mitrovicë të një ushtrie të madhe, e cila me rreth 1 500 ushtarë të mbështetur nga artileria do të rrethonte fshatrat Galicë, Lubovc dhe Mikushnicë të Drenicës,⁶⁴ me qëllimin për të eliminuar Azem Bejtën. Luftime të ashpra midis forcave të Azem Bejtës dhe atyre ushtarake e të xhandarmërisë serbo-kroate-sllovene u zhvilluan gjatë 15-16 korrikut të vitit 1924. Në këtë betejë u plagos Azem Bejta, por bashkëluftëtarët e tij kishin arritur ta largonin nga rrethimi dhe ta dërgonin në Çiçavicë, ku ndërroi jetë

⁶¹ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia, 1919-1927...*, f. 208-209.

⁶² M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 57.

⁶³ Hivzi Islami, *Spastrimet etnike - politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptarëve*, Pejë: Dukagjini, 2003, f. 196.

⁶⁴ Islam Dobra, *Krerë dhe prijës të Lëvizjes Kombëtare nga Drenica, 1878-1948*, pjesa II, Prishtinë, 1997, f. 87; *Политика*, Београд, 16 јула 1924, f. 3.

më 24 korrik 1924. Në këtë sulm ushtria dhe xhandarmëria serbe vrau 75 shqiptarë dhe dogji 120 shtëpi në fshatrat e rrethuara. Ndër të vrarët 19 ishin bashkëlufetarë të Azem Galicës, kurse të tjerët ishin civilë të pambrojtur e duarthatë - pleq, gra e fëmijë,⁶⁵ kurse sipas gazetës serbe të kohës ishin vrarë rreth 200 shqiptarë dhe 15 xhandarë e ushtarë.⁶⁶

Pas eliminimit të Azem Bejtës qeveria serbo-kroate-slllovene vazhdoi me përpjekjet për eliminimin e plotë të Lëvizjes Kaçake. Komanda e xhandarmërisë së Mbretërisë SKS më 8 nëntor 1924 njërive të saja vartëse ua përcolli “Udhëzimin për punën e xhandarmërisë në shkatërrimin e bandave kaçake në “Serbinë e Jugut”, në të cilin shqiptarët karakterizoheshin kështu: “Në shumë rrethe të Serbisë jetojnë shqiptarë, popull i egër, i pakulturuar, i pabesueshëm, dinak, i padëgjueshëm, me botëkuptime juridike nga perioda më e hershme e zhvillimit të së drejtës penale “reaksionit privat”, që shprehet në formë të hakmarrjes. Pos kësaj, ky popull nuk pranon kurrfarë këshille e as udhëzimi dhe është plotësisht konservator në botëkuptimet e tij të vjetërsuara mbi të drejtat dhe detyrat ndaj shtetit”.⁶⁷

Njëkohësisht qeveria në fjalë u orientua në ndalimin e veprimtarisë politike shqiptare dhe në persekutimin e figurave me ndikim tek popullsia shqiptare. Kështu, pas ndalimit të veprimtarisë së Xhemijetit⁶⁸ pushteti serb-kroat-sllloven organizoi vrasjen e figurave të shquara shqiptare. Në maj të vitit 1927 vritet Nazim Gafurri, deputeti shqiptar që kishte bërë protesta kundër veprimeve kolonizuese serbe në Kosovë,⁶⁹ kurse më 1929 vritet edhe prifti shqiptar Shtjefen Gjeçovi.⁷⁰

Presioni i vazhdueshëm shtetëror ndaj shqiptarëve dhe politika jugosllave për ndryshimin e strukturës etnike dhe shkombëtarizimin e viseve të banuara me shqiptarë dëshmohej në mënyrë të dokumentuar përmes memorandumit të titulluar “Gjendja e pakicës shqiptare në Jugosllavi”, të dorëzuar në Lidhje të Kombeve më 5 maj 1930 nga Don Gjon Bisaku, Don Shtjefen Kurti dhe Don Luigj Gashi.⁷¹ Në këtë dokument, një politikë e tillë

⁶⁵ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 58-59; H. Bajrami, *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb...*, f. 97.

⁶⁶ *Политика*, Београд, 16 јула 1924, f. 3

⁶⁷ AK, Fondi: Arkivi Ushtarak ne Beograd, Popisnik 17; Ali Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)”, *E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi*, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1990, f. 243.

⁶⁸ H. Hoxha, “Partitë politike dhe lëvizjet e tyre ndër shqiptarë në Jugosllavinë borgjeze”, *Prishtinë: Përparimi*, nr. 12, 1971, f. 1006.

⁶⁹ H. Bajrami, *Rrethanat shoqërore dhe politike...*, f. 138

⁷⁰ *Arkivi i Institutit të Historisë Tiranë*, Fondi: A-84, viti: 1930, f. 254.

⁷¹ H. Islami, *Spastrimet etnike - politika gjenocidiale serbe ndaj shqiptarëve...*, f. 190.

pasqyrohej përmes tri dimensioneve kryesore: (a) persekutimit të të gjitha llojeve për ta bërë të detyrueshëm largimin; (b) përdorimi i dhunës për shkombëtarizimin e detyruar të popullsisë, e cila është vënë në pamundësi për të kundërvepruar; (c) syrgjynosje dhe shfarosje e elementeve që nuk pranojnë as të lënë vendin e as t'i nënshtrohen serbizimit.⁷² Më tej, përmes shtojcave të veçanta dokumenti në fjalë ofron detaje të specifikuar mbi shpërnguljen e detyruar, kufizimin e lirisë individuale, mohimin e të drejtave pronësore, konfiskimet e pasurive, reformën agrare, mohimin e të drejtave qytetare, mohimin e përdorimit të gjuhës kombëtare, të arsimit në gjuhën amtare, etj.⁷³

Shkeljet e të drejtave elementare njerëzore e etnike ishin kryer pavarësisht zotimit të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene për të respektuar të drejtat e pakicave përmes nënshkrimit të Traktatit të Sen Zhermenit në shtator të vitit 1919. Neni 2 i këtij traktati pohonte se shtetit serb-kroat-slloven “... *obligohet që gjithë banorëve të saj t’u siguroj mbrojtje të plotë dhe të përgjithshme të jetës dhe lirisë pavarësisht nga origjina, etniteti, gjuha, raca apo besimi fetar*”, ndërsa neni 7 theksonte se “... *asnjë lloj kufizimi nuk do të ketë në përdorimin e cilësdo gjuhë nga secili qytetar i shtetit serbo-kroat-slloven qoftë në raportet private apo tregtare, qoftë në aspekt të religjionit, shtypit apo takimeve publike*”.⁷⁴

Shteti serb-kroat-slloven nuk i konsideroi shqiptarët si pakicë etnike, por u përpoq që t’i dëbojë dhe t’i asimilojë. Kështu, përmes rregullimit administrativ të vitit 1929 dhe ndarjes administrative-territoriale në krahina të cilat u quajtën banovina, qeveria jugosllave* u përpoq të thyente kompaktësinë etnike të shqiptarëve. Jugosllavia u nda në 9 banovina, kurse territori i Kosovës në 3 banovina: të Vardarit, të Zetës dhe të Moravës.⁷⁵ Në këto territore, sipas të dhënave në dispozicion del se në Kosovë më 1921 kishte 461 970, më 1931 552 352 e në mars të vitit 1941 kishte 660 276 banorë. Në bazë të të dhënave mund të vërtetojmë se shqiptarët përbënin 70% të popullsisë, kurse pjesën tjetër me shumicë e përbënin serbët dhe një numër të vogël malazezët.⁷⁶

⁷² *Gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi*, Prememorie e paraqitur në Lidhje të Kombeve (1930) nga Dom Gj. Bisak, Dom Sh. Kurti, Dom L. Gashi, Tiranë: Koha, 1995, f. 25.

⁷³ *Po aty*.

⁷⁴ AK, Fondi: Arkivi Diplomatik Beograd, Njësia organike: Lidhja e Kombeve, Fashikulli 12, Dosja 6, f. 1-4.

* Në vitin 1929 Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene emërtohet në Mbretëria e Jugosllavisë.

⁷⁵ L. Rushiti, *Ndarja territoriale dhe rregullimi administrativ i Kosovës*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2004, f. 79-80.

⁷⁶ A. Hadri, “Pozita dhe gjendja e Kosovës në Mbretërinë e Jugosllavisë (1918-1941)”, *Gjurmime albanologjike*, Nr. 2-1968, Prishtinë: Instituti Albanologjik, 1968, f. 164.

Si rezultat i një politike të tillë shqiptarët jetonin në kushte presioni të vazhdueshëm, duke qenë të detyruar të shpërnguleshin në Shqipëri apo Turqi. Presioni shtetëror merr një dimension të ri kah mesi i viteve 1930 kur qarqet politike serbe, të vetëdijshme se reforma agrare dhe kolonizimi nuk kishin dhënë rezultatet e pritura,* filluan me hartimin e projekteve të reja për shkombëtarizimin e viseve të banuara me shqiptarë. Deri në fund të vitit 1930 qeveria jugosllave hartoi tri elaborate antishqiptare. Njëri kishte të bënte drejtpërdrejt me shpërnguljen e shqiptarëve, kurse dy të tjerat për copëtimin e Shqipërisë midis Jugosllavisë e Italisë.

Elaborati i Vasa Çubriloviqit, i vitit 1937, i hartuar me tone shoviniste që parashihte shpërnguljen në masë të shqiptarëve, buronte nga pajtimi turko-jugosllav për shpërnguljen e popullsisë “myslimane” për në Turqi, një mirëkuptim i arritur në parim midis ministrit të Jashtëm turk, Ruzhdi Aras, dhe homologut të tij jugosllav, në takimin e mbajtur në shkurt të vitit 1933 në Beograd.⁷⁷ Elaboratin që Vasa Çubriloviqi e lexoi para anëtarëve të Klubit kulturor serb, në mars të vitit 1937, me titull “Shpërngulja e arnautëve”, parashihte rëndësinë dhe mënyrat për realizimin e shpërnguljes së shqiptarëve: të përfitohej elementi fetar dhe njerëzit me ndikim përmes të hollave apo kërcënimit për të propaganduar pozitivisht jetën në Turqi, dhe të shfrytëzimit të ligjeve në mënyrë rigoroze që shqiptarëve t’u vështirësohej jeta përmes gjobave, dënimeve, arrestimeve, burgosjeve, ndjekjeve, mohimit të së drejtave pronësore, konfiskimit të pronave, nxitja e kolonëve dhe elementit malazez për konflikte të armatosura me shqiptarët, etj.⁷⁸

Qëllimi dhe metodat e zbatimit të tij paraqesin përpjekje për një akt gjenocidi të planifikuar në baza shtetërore, sepse, spastrimi etnik i shqiptarëve parashihej në dy mënyra të cilat pasqyrohen në projektin e komitetit ndërministror të qeverisë jugosllave, të formuar më 1935 për përgatitjen e planit për shpërnguljen e shqiptarëve. Konkluzionet e dala nga ky komitet konsistonin nga njëra anë në shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi përmes një konvente ndërshtetërore, kurse nga ana tjetër, që pjesa e

* Në periudhën midis dy luftërave botërore nga Kosova për në Shqipëri, Bullgari e Turqi u shpërngul një numër prej 90 000 deri 150 000 banorësh shqiptarë, kurse në bazë të programeve serbe sikurse Reforma Agrare dhe Kolonizimi në Kosovë u vendosën rreth 53 000 banorë sllavë.... për më tepër shih: Oliver Jens Schmitt, *Kosova – Histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, Prishtinë: Koha, 2012, f. 158; Noel Malcolm, *Kosova një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 2011, f. 367; Milovan Obradoviç, *Reforma Agrare dhe kolonizimi në Kosovë (1918-1941)*, Prishtinë: Instituti i Historisë, 2005, f. 261.

⁷⁷ *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve*, Shoqata për Kthimin e Shqiptarëve të Shpërngulur nga Kosova, Prishtinë, 1992, f. 178.

⁷⁸ M. Ndreca, *87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror...*, f. 81.

mbetur e shqiptarëve të shpërngulej brenda Jugosllavisë për t'u asimiluar më pas nga popullata mbizotëruese sllave.⁷⁹ Konventa turko-jugosllave e vitit 1938 parashihte që brenda gjashtë vjetëve (1939-1944) nga Jugosllavia në Turqi do të shpërnguleshin 40 000 familje “myslimane” të Serbisë Jugore, pra të viseve që iu dhanë Serbisë e Malit të Zi pas luftërave të viteve 1912-1913.⁸⁰ Konventa nuk u realizua për shkak të shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore.

Përfundimi i Luftës së Parë Botërore dhe ripushtimi serb i Kosovës u shoqërua me vazhdimin e politikës serbe të shkombëtarizimit dhe ndryshimit të strukturës etnike të Kosovës. Rezistenca ndaj pushtimit serb pati rrjedhojë organizimin e fushatave të armatosura, me pretekstin e çarmatimit të popullsisë, gjatë viteve 1919-1921, të cilat u karakterizuan me një brutalitet të ashpër që rezultoi me vrasje në masë, ekzekutime, djegie të vendbanimeve, plaçkitje të ushqimeve dhe grabitje të bagëtive. Sipas të dhënave të Komitetit “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” vetëm gjatë viteve 1919-1921 u vranë gjithsej 12 346 shqiptarë, u burgosën rreth 23 600, ndërsa kishte 6 025 shtëpi të djegur dhe 10 515 të plaçkitura.

Gjatë këtyre fushatave pushteti serbo-kroat-slloven përdori edhe metoda të ndryshme në arritjen e qëllimeve të tyre sikurse: internimet, pengmarrja, konfiskimet e pasurisë, etj. Krahas këtyre fushatave të karakterit policor e ushtarak, pushteti serb inicioi edhe ligje administrative për të arritur ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës, sikurse Reforma Agrare dhe Kolonizimi. Këto procese po ashtu u shoqëruan me padrejtësi dhe dhunë kundër elementit shqiptar. Në memorandumun që disa klerikë katolikë shqiptarë e deponuan në Lidhje të Kombeve në maj të vitit 1930, pasqyrohet persekutimi dhuna për të nxitur shkombëtarizimin si dhe gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë, e cila përballej me mohimin e të drejtave elementare njerëzore dhe etnike, kufizimin e lirisë së lëvizjes, mohimin e të drejtave të përdorimit të gjuhës dhe simboleve kombëtare, të edukimit në gjuhën amtare, etj. Rezistenca e elementit shqiptar dhe mosarritja e rezultateve të dëshiruara nxiti qarqet serbe të hartonin programe të reja antishqiptare. Kështu, në bazë të një elaborati u arrit marrëveshja turko-jugosllave për shpërnguljen e 40 000 familjeve shqiptare në Turqi gjatë viteve 1939-1943, që dështoi për shkak të fillimit të Luftës së Dytë Botërore.

⁷⁹ *Shpërnguljet e shqiptarëve gjatë shekujve...*, f. 179.

⁸⁰ AK, Fondi: Arkivi diplomatik i MPJ, Poslanstvo Krajevine Jugoslavije u Turskoj, Kutia 3, 1939, f. 65-66.